



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.10.2024
REFERENC-Ë:	24/5021/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Eling Grup", Sh.p.k, Prishtinë, Parku Solar, Llabjan, K.Pejë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit, "Eling Grup", Sh.p.k, Prishtinë, Parku Solar, Llabjan, K.Pejë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

- Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin, "Eling Grup", Sh.p.k, Prishtinë, Parku Solar, Llabjan, K.Pejë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/5021/MMPHI
Datë: 17.10.2024.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "Eling Grup", Sh.p.k, Prishtinë, me nr. prot. 24/5021/MMPHI, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Parku Solar, Llabjan, K.Pejë. në ngastrën nr. 210-54, zona kadastrale Llabjan, Pejë.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të mirëmbahen shtresat antirefektuese në modulet solare, ku janë të vendosura qelqet ballore speciale për të ndaluar reflektimin e dritës;
 - 2.3. Të mirëmbahen pajisjet kundër zjarrit;
 - 2.4. Për sistemin menaxhues të mjedisit të ketë personin përgjegjës të profilit mjedisor;
 - 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe aktivitetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; <https://mmphi.rks-gov.net/>



A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "Operatori, "Eling Grup", Sh.p.k, Prishtinë, me nr. prot. 24/5021/MMPHI, për veprimtarinë: Parku Solar, Llabjan, K.Pejë në ngastrën nr. 210-54, zona kadastrale Llabjan, Pejë, konstatohet që operatori plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.


Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me nr. 22/50/1-ZSP/118/23, të lëshuar me datë: 27.02.2023;
- Leje ndërtimore nr.08-351-24941, të lëshuar me datë: 17.03.2023, nga K. Pejë;
- Pëlqim për vendosje e panelev solare, nr.08-350-10734, të lëshuar me datë: 16.03.2023, nga K. Pejë;
- Vendim nga zyra Rregullatorit për Energji, nr. prot. 412/23, të lëshuar me datë: 18.08.2023;
- Pëlqim Elektorenergjetik nga KEDS, nr.10733, të lëshuar me datë: 06.08.2024;

Andaj bazuar në të cekurat më lartë dhe gjendjes faktike në teren, si dhe plotësimit të kushteve të parapara me legjislacionin mjedisor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Pejë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së